



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 2221

NR. VENDIMI 1328

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Nr. 2221Akti

Nr. 1328

Vendimi

Dt.16.07.2018

DT.25.02.2019

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, E PËRBËRË NGA:
ENEIDA CIVICI – GJYQTARE

Asistuar nga sekretare gjyqësore Anjeza Nergjoni, sot më datë 25.02.2019, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile me Nr.2221 akti, që i përket: PADITËS:Shoqëria ***, NUIS: ***, me zyrë qendrore në adresën: ***, përfaqësuar nga Av. *** dhe Av. ***.

I PADITUR: ***, rregjistruar si *** me NUIS ***, përfaqësuar me prokurën me Nr. ***, nga Av. *** me Nr. licence ***, Dhoma e Avokatisë ***, adresa: *** (i papranishëm në shpallje).

OBJEKTI: 1.Detyrimi i te Paditurit per te paguar kushtin penal ne vleren prej *** Euro (***) si pasoje e shkeljes se dispozitave te Marreveshjes per Perfundim me Pelqim Reciprok.
2.Ndalimin e veprimeve te te Paditurit qe kane te bejne me perdorimin e Markes dhe shenjave dalluese ne kushtet e konkurrences se pandershme ndaj Paditesit.

Në përfundim të gjykimit palët kërkuar:

Paditësi kërkoj: Pranimin e padisë.

I padituri: Rrëzimin e padisë.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje, pasi shqyrtoi provat e paraqitura në gjykim, dëgjoi palët dhe analizoi çështjen në tërësi

V Ë R E N

Çështja i përket juridiksionit gjyqësor dhe gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është kompetente për shqyrtimin e saj.

Rrethanat e faktit:

Pala paditëse është shoqeri tregëtare më përgjegjësi të kufizuar e cila ka si objekt të aktivitetit: “Krijim zhvillim zyra ndermjetesimi per pasurite e paluajtshme nepermjet nenshkrimit te nje kontatete veçante Franchising; nen licensimif ranshizmarres vene nëpermjet dhenies se autorizimit per perdorimin e markes "****" dhe gjithë sistemit qe perbehet nga plane, mjete marketingu, etj. neperputhje me kushtet e parashikuara ne marreveshjen per perdorimin e markes.”

Pala e paditur *** është rregjistruar si tregëtar person fizik, me emër tregëtar: *** *** e cila ushtron aktivitetin si Zyrë imobiliare.

Midis palës paditëse dhe palës së paditur ka qenë e lidhur një kontratë Franchise në datë 09.06.2014, me disa amendime.

Në datë 25.04.2018 midis palëve është lidhur një marrëveshje për përfundimin e kontratës së sipërcituar në referim të pikës 16 të kontratës Franchise që ishte lidhur në datë 09.06.2014.

Në këtë marrëveshje parashikohet si kusht penal, pagesa e një shumë prej *** Euro vetëm ndaj Franchisemarrësit “**** ****”, emri tregtar i tregëtarit *** person fizik i rregjistruar dhe emër tregëtar i përcaktuar i Franchisemarrësit sipas kontratës së Franchise.

Ky kusht penal ishte vendosur në rast mospermbushje në mënyrë të duhur të detyrimeve të kësaj marrëveshjeje brenda një afati prej 30 ditësh nga data e nënshkrimit të saj. Pra detyrimet duhet të përmbusheshin brenda datës 25.05.2018.

Sipas Marrëveshjes së Përfundimit, detyrime të cilat duhet të ekzekutoheshin i padituri brenda afatit të sipërpermendur përfshinin, ndër të tjera:

Heqjen e markes *** (“Marka”) nga çdo postim në rrjetet sociale të të paditurit dhe të bashkëpunetoreve të tij të shitjeve;

Mbylljen e emailit me domainit që përmban Marken;

Njoftimin e të gjithë klienteve të kaluar dhe aktualë për shkeputjen e biznesit të të Paditurit nga sistemi *** (“Sistemi”);

Heqjen e Markes nga çdo publikim/rrëgjistrim apo çdo vend tjetër ku kjo markë është përdorur nga i Padituri.

Me datë 29.05.2018 është mbajtur procesverballi për dorëzimin e materialeve sipas përshkrimit.

Me datë 01.06.2018, paditësi në cilësinë e ish- Franchisedhënësi ka kërkuar nga ish-Franchisemarrësi, dokumente provuese për përmbushjen e detyrimeve.

Me datë 05.06.2018, Franchisemarrësi, në përgjigje të shkresave të datës 01.06.2018 informon dhe sqaron Franchisedhënësin „midis të tjerash“ se:

Kemi njoftuar në mënyrë publike nëpërmjet postimeve në mediat sociale të gjithë klientët tanë, bashkëpunëtorët dhe palët e treta për largimin nga ***.

Caktoni një ditë për inspektim, heqje tabelle dhe shenjash. Këtë ua kam kërkuar edhe në email-in e datës 25.05.2018.

Në mendojmë që kemi hequr çdo shenjë *** që kemi pasur, por nëse ju jeni në dijeni të diçkaje që mund të na ketë shpëtuar, lutem të na thoni e ta heqim menjëherë.

Marka me të cilën ne po punojmë, *** është Nr.1 absolut në botën e ndërmjetësimin e pasurive të paluajtshme. Ka rregulla strikte dhe nuk lejon praninë e asnjë shenje të një marke tjetër, aq më pak një marke me pak të njohur. Për këtë arsye, është tërësisht pa kuptim që në të kemi shenja apo gjurmë të markës ***.“

Parashikimet ligjore:

Kodi Civil parashikon se :

KUSHTI PENAL

Neni 541

Për mosëkzekutimin ose ekzekutimin jo në mënyrën e duhur të detyrimeve, palët mund të parashikojnë në kontratë pagimin e një shume të hollash ose kryerjen e një detyrimi tjetër, për riparimin e dëmit ose për të nxitur ekzekutimin e detyrimit.

Neni 542

Kreditori nuk mund të kërkojë në të njëjtën kohë pagimin e kushtit penal dhe ekzekutimin e detyrimit.

Neni 543

Kur kushti penal është caktuar për rastin e mosëkzekutimit të detyrimit dhe debitori nuk ekzekuton detyrimin e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë pagimin e kushtit penal, si dhe shpërblimin e pjesës së dëmit që kalon kushtin penal. Kur kushti penal është caktuar për rastin e ekzekutimit të detyrimit jo në mënyrën e duhur, dhe debitori nuk e ka ekzekutuar detyrimin e tij në mënyrën e duhur, kreditori ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e detyrimit

dhe pagimin e kushtit penal, si dhe shpërblimin e pjesës së dëmit që kalon kushtin penal.

Neni 544

Kur kushti penal është tepër i madh në krahasim me dëmin e pësuar nga kreditori, gjykata me kërkesën e debitorit mund të pakësojë kushtin disiplinor deri në nivelin e dëmit të pësuar.

Neni 545

Marrëveshja për kushtin penal duhet të bëhet me shkresë, pavarësisht nga madhësia e tij dhe nga forma që kërkohet për kontratën kryesore.

KONKURRENCA E PANDERSHME

Neni 638

Në varësi të dispozitave që kanë lidhje me mbrojtjen e shënjave dalluese dhe të drejtave të patentës, veprimet e konkurrencës së pandershme kryhen prej cilitdo që: 1. përdor emrat ose shënjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti; 2. trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit; 3. përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit.

Neni 639

Vendimi që vërteton veprime të konkurrencës së pandershme ndalon vazhdimin e tyre dhe përcakton masat e nevojshme me qëllim që të zhduken pasojat. Në qoftë se këto veprime janë kryer me faj, personi që i ka kryer detyrohet të shpërblejë dëmin.

Neni 140 i ligjit 9947 datë 07.07.2008 i ndryshuar parashikon se: “Shenjat që mund të përbëjnë markë”

Një markë mund të jetë çdo shenjë, në veçanti fjalët, duke përfshirë emrat personalë ose disenjimet, shkronjat, numrat, ngjyrat, formën e mallrave ose të paketimeve të tyre ose tingujt, me kusht që këto shenja të jenë të afta:

- a) të dallojnë mallrat apo shërbimet e një personi fizik apo juridik nga ato të një personi tjetër fizik apo juridik;
- b) të përfaqësohen në regjistër në mënyrë të tillë, që të mundësojnë autoritetet kompetente dhe publikun të përcaktojnë qartë dhe saktë objektin e mbrojtjes që i njihet pronarit të saj.”.

Në përfundim të analizën e faktit dhe të ligjit, gjykata do të mbajë në konsideratë nenin 16 të Kodit të Proçedurës Civile, I cili parashikon se gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të bëjnë palët.

Në vendimin unifikues Nr.9 datë 09.03.2006 Gjykata e Lartë ka unifikuar praktikën se gjykata është e detyruar që të bëjë cilësimin e saktë të ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike, por pa ndryshuar bazën ligjore të padisë e cila është vetëm në disponim të paditësit.

Në vendimin nr.3 datë 29.03.2012 Gjykata e Lartë ka unifikuar praktikën se: Në këtë kuptim, gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cënuar.”

Pra gjykata ka detyrimin ligjor të mos I referohet bazës ligjore të padisë së paditësit I

cili mund ta referojë atë dhe gabim por të zbulojë nga kërkesë padia të drejtën që paditësi kërkon të mbrojë duke përcaktuar drejt shkakun ligjor të padisë nga faktet e ngjara dhe të drejtat e cënuara.

Gjykata çmon se padia duhet të pranohet si e bazuar në prova dhe në ligj.

Në rastin konkret pala paditëse kërkoi pagimin e kushtit penal të përcaktuar lirisht nga palët në marrëveshjen e datës 05.06.2018.

Për të kuptuar se cili ka qenë qëllimi i palëve në parashikimin e këtij penalteti kontraktor, është e rëndësishme të kuptojmë se çfarë është kushti penal kjo referuar dispozitave ligjore.

Kushti penal është një ndëshkim, i cili përfaqëson vlerësimin e dëmeve dhe interesave që mund të pësojë kreditori si rezultat i mospërbushjes së detyrimeve ose ekzekutimit të vonuar të detyrimeve nga ana e debitorit. Në nenin 541 të Kodit Civil kushti penal përkufizohet si detyrimi për të paguar një shumë të hollash ose për të kryer një detyrim tjetër (të ndryshëm nga ai kryesor) për riparimin e dëmit ose për nxitjen e ekzekutimit të detyrimit.

Në nenin 542 të Kodit Civil parashikohet se: “Kreditore nuk mund të kërkojë në të njëjtën kohë pagimin e kushtit penal dhe ekzekutimin e detyrimit”. Ndërsa, në nenin 543 parag. 1 të Kodit Civil parashikohet se: “Kur kushti penal është caktuar për rastin e mosekzekutimit të detyrimit dhe debitori nuk ekzekuton detyrimin e tij, kreditore ka të drejtë të kërkojë pagimin e kushtit penal, si dhe shpërblimin e pjesës së dëmit që kalon kushtin penal”. Dhe se fundi, në nenin 543 parag. 2 të Kodit Civil parashikohet se: “Kur kushti penal është caktuar për rastin e ekzekutimit të detyrimit jo në mënyrën e duhur, dhe debitori nuk e ka ekzekutuar detyrimin e tij në mënyrën e duhur, kreditore ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e detyrimit dhe pagimin e kushtit penal, si dhe shpërblimin e pjesës së dëmit që kalon kushtin penal”.

Sa më lart, nisur nga përmbajtja e neneve 542 dhe 543 Kodit Civil, rezulton se kemi të bëjmë me kusht penal vlerësues, kur ai përfaqëson vlerën e dëmit që pëson kreditore si rezultat i mospërbushjes së detyrimit nga ana e debitorit. Në këtë rast kreditore ka të drejtë të kërkojë ose ekzekutimin e detyrimit ose pagimin e kushtit penal por jo të dyja. Ndërsa, nga përmbajtja e nenit 543 parag 2 i K.Civil rezulton se kemi të bëjmë me kusht penal disiplinor (gjobor), i cili caktohet me marrëveshje të palëve me qëllim për të nxitur ekzekutimin e detyrimit, madje kreditore ka të drejtë që në një rast të tillë të kërkojë ekzekutimin e detyrimit dhe pagimin e kushtit penal.

Sa më sipër palët mund të kërkojnë pagimin e kushtit penal disiplinor (gjobor) vetëm duke kërkuar së bashku me të dhe përmbushjen e detyrimit, pasi qëllimi I përcaktimit të një kushti penal është detyrimi dhe nxitja e debitorit për të përmbushur detyrimin. Ndërkohë që kushti penal vlerësues është I përcaktuar nga kreditore I cili paraprakisht ka vlerësuar dëmin që I shkaktohet interesave të tij si rezultat i mospërbushjes dhe ai kërkon vetëm pagesën e kushtit penal. Në rastin konkret për të kuptuar se cili është lloji dhe masa e kushtit penal të parashikuar nga palët në marrëveshjen, duhet t'i referohemi parashikimeve të saj për mënyrën e ekzekutimit të detyrimit.

Përmbushja e detyrimit nga pala e paditur, sipas marrëveshjes lidhur në datë 25.04.2018 ishte të kryente këto veprime:

Heqjen e markes *** (“Marka”) nga çdo postim ne rrjetet sociale te te paditurit dhe te bashkepunetoreve te tij te shitjeve;

Mbylljen e emailit me domainit qe permban Marken;

Njoftimin e te gjithë klienteve te kaluar dhe aktuale per shkeputjen e biznesit te te Paditurit

nga sistemi *** (“Sistemi”);

Heqjen e Markes nga çdo publikim/rregjistrim apo çdo vend tjetër ku kjo marke është përdorur nga i Padituri.

Nga interpretimi sa më lart i mënyrës se si do të realizohej zbatimi i marrëveshjes, gjykata çmon se pala paditëse ka dashur dhe ka shprehur qëndrimin se pala e paditur duhej të kryente me rastin e lidhjes së marrëveshjes për zgjidhjes së kontratës franchise disa veprime që të mos kishte asnjë konfondim prej personave të tretë dhe publikut se kontrata midis tyre kishte përfunduar. Sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se penalteti i parashikuar në kontratë nga palët ndërgjyqëse, nisur nga masa e përcaktuar në të dhe mënyra e ekzekutimit të kontratës, është një kusht penal gjobor pasi me anë të tij pala paditëse ka dashur të nxit të paditurin që brenda 30 ditëve të kryente të gjitha veprimet e shënuara në marrëveshje. Kjo lloj nxitje ka qenë për efekt të shmangies së konkurrencës duke u njohur menjëherë publiku i gjerë mbi faktin që i padituri nuk kishte më një marrëveshje bashkëpunimi me paditësin për më tepër që i padituri ka lidhur një kontratë me një nga konkurrentët që operojnë në të njëjtën fushë me paditësin.

Pala paditëse për të provuar se nga i padituri janë kryer shkelje të marrëveshjes së datë 25.04.2018 përsa i përket detyrimit të pare të përcaktuar në të dhe konkretisht: Heqjen e markes *** (“Marka”) nga çdo postim në rrjetet sociale të paditurit dhe të bashkëpunetoreve të tij të shitjeve paraqiti 11 printime të faqeve elektronike *** në rrjetin social Instagram dhe *** Tirane në rrjetin social Facebook.

Këto printime janë kryer prej noterit në datë 06.07.2018. Pala e paditur kundërshtoi marrjen e tyre si prove dhe vërtetësinë e tyre duke pretenduar se dokumentet e vlerësuara si elektronike nga noteri nuk janë të tilla pasi nuk plotësojnë asnjë nga këto kushte që parashikon ligji dhe se noteri ka bërë shkelje të rëndë në formën e elementëve të anës objektive të veprës penale të “shpërdorimit të detyrës” të parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal, duke vërtetuar në letër një dokument jo elektronik sikurse parashikon ligji, por në thelb faqe sociale fals dhe lehtësisht të manipulueshme për qëllime dashakeqëse nga ana e paditësit ndaj të paditurit duke u përdorur për qëllime të dëmtimit të interesave të ligjshme të të paditurit.

Gjykata vëren se nga ana e të paditurit nuk është paraqitur asnjë prove e tillë që të provojë se këto faqe facebook dhe instagram që janë printuar nga noteri dhe që përmbajnë numër telefoni, adresë e të dhëna të tjera nuk i përkasin të paditurit. Nuk rezultoi që i padituri të ketë kryer ndonjë kallëzim penal për përvetësim të dhënash apo të kundërshtonte në gjykim nëpërmjet provave numrin e telefonit apo adresën e vendosur në këtë faqe facebook apo faqe instagrami. Pretendimi të paditurit se vërtetimi nga noteri i këtyre faqeve nuk i bën këto prova të marra në formën e kërkuar nga ligji është i pabazuar në ligj dhe në prova. Gjykata vëren se përsa kohë i padituri ka qenë i detyruar në bazë të marrëveshjes që të të heqi shenjat dalluese të paditësit nga rrjetet sociale, atehere nuk ka asnjë formë tjetër të ligjshme për të aksesuar në to dhe për të provuar se nuk është përmbushur detyrimi dhe për tu paraqitur si prove përveçse nëpërmjet noterit. Gjykata vëren se pala e paditur nuk prapësoi me asnjë prove këto printime për fallsitet apo për të dhëna të rreme dhe as prapësoi apo provoi se më pare i kishte ndodhur ti kryheshin veprime të tilla në faqet e tij online.

Gjykata çmon se pala e paditur në fakt më shumë u mundua të prapësonte këto prova për ti bërë të papërdorshme pasi ato janë të vetmet prova që në fakt provojnë nese i paditur ka shkelur apo jo pikën e pare të marrëveshjes së lidhur midis palëve.

Gjykata vëren se nga ato prova qartësisht vërehet se krahas sigles së *** të mbi fotot e pasurive të reklamuar mbi këto faqe është e shkruar ***, emri i markës së palës paditëse. Gjykata vëren gjithashtu se në to është shënuar adresa e emailit info@*****.al adresë të cilën pala e paditur nuk duhet ta përdorte më 30 ditë pas lidhjes së marrëveshjes së datës 25.04.2018. Gjykata vëren se këto printime janë kryer sipas vërtetimit nga noteri në datë

06.07.2018 ndërkohë që afati i të paditurit për ti hequr ato sipas marrëveshjes përfundonte në datë 25.05.2018.

Në marrëveshjen e lidhur midis palëve të datës 25.04.2018 ata kanë parashikuar gjithahstu që Brenda afatit 30 ditor pala e paditur duhet të njoftonte te gjithë klienteve te kaluar dhe aktuale per shkeputjen e biznesit te te Paditurit nga sistemi ***. Për këtë qëllim pala paditëse i ka dërguar një shkresë paditësit në datë 01.06.2018 ku i kërkon informacion lidhur me zbatimin e kësaj pike të marrëveshjes. Rezulton se i padituri më datë 05.06.2018 sqaron paditësin midis të tjerash se:

Kemi njoftuar në mënyrë publike nëpërmjet postimeve në mediat sociale të gjithë klientët tanë, bashkëpunëtorët dhe palët e treta për largimin nga ***.

Caktoni një ditë për inspektim, heqje tabele dhe shenjash. Këtë ua kam kërkuar edhe në email-in e datës 25.05.2018.

Ne mendojmë që kemi hequr çdo shenjë *** që kemi pasur, por nëse ju jeni në dijeni të diçkaje që mund të na ketë shpëtuar, lutem të na thoni e ta heqim menjëherë.

Marka me të cilën ne po punojmë, *** është Nr.1 absolut në botën e ndërmjetësimit e pasurive të paluajtshme. Ka rregulla strikte dhe nuk lejon praninë e asnjë shenje të një marke tjetër, aq më pak një marke me pak të njohur. Për këtë arsye, është tërësisht pa kuptim që në të kemi shenja apo gjurmë të markës ***.“

Gjykata vëren se nga i padituri nuk u provua me asnjë provë se ka kryer veprimet e sipërcituara. Në fakt gjykata çmon se përse kohë ky kusht ishte pjesë e marrëveshjes midis palëve atëhere pala e paditur ka patur detyrimin që ti provonte paditësit që më datë 05.06.2018 se i kishte kryer veprimet e sipërcituara dhe nuk rezulton që kësaj shkrese ti jetë bashkangjitur ndonjë akt i tille.

Gjykata vëren se nga ekstrakti i QKB-së së paraqitur si provë në gjykim i datës 02.07.2018 rezulton se në këtë datë (pra jashtë afatit 30 ditor të marrëveshjes) personi fizik *** me nipt *** figuron i rregjistruar me status aktiv me emër tregëtar *** ***.

Gjykata vëren se marrëveshja e lidhur midis palëve përse a i përket kushteve të përcaktuara në të për tu plotësuar nga i padituri nuk i ka ato kumulative. Mjaftonte që vetëm njëri nga ato kushte të mos plotësohej nga i padituri dhe midis palëve do të zbatohej kushti penal gjobor i përcaktuar. Gjykata çmon se është në të drejtën e çdo mbajtësi të një marke që të kërkojë nga të tretët që të mos përdorin shenjat tij dalluese ku futet emri sigla etj dhe në rastin konkret pala e paditur e cila ka lidhur tashmë një kontratë me një person tjetër juridik që ushtron veprimtari në të njëjtën fushë si paditësi në fakt ka përdorur këto shenja dhe emërtime në rrjetet sociale nëpërmjet fotove, e-mailit dhe emrin tregëtar të rregjistruar pranë QKB-së.

Nisur nga sa më sipër gjykata çmon se i padituri nuk i ka përmbushur detyrimet e marrëveshjes së datës 25.04.2018 ndaj paditësit dhe prandaj ai duhet të paguajë kushtin penal ndaj paditësit të përcaktuar lirisht midis palëve.

Gjykata çmon gjithashtu se mos ndalimi i përdorimit të emrit apo shenjave të paditësit nga i padituri përbën konkurrencë të pandrëshme. Për rrjedhojë i padituri duhet të ndalojë ç' do lloj veprimi në përdorimin e markes dhe shenjave dalluese të të paditësit per më tepër në kushtet kur i padituri tashmë ka lidhur një kontratë me një tjetër kompani e cila ushtron të njëjtin aktivitet më palën paditëse.

Nisur nga sa më sipër gjykata çmon se padia duhet të pranohet si bazuar në prova dhe në ligj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 476 të K.Civil dhe 306 e vijues të K.Pr.Civile,
VENDOSI

1. Pranimin e padise se paditësit shoqëria *** duke u detyruar pala e paditur ***, rregjistruar si *** me NUIS ***, ti paguajë paditësit vlerën *** euro.
7. Shpenzimet gjyqësore të kryera nga pala paditëse i ngarkohen i ngarkohen palës së paditur.
8. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi të arsyetuar.

U shpall në Tiranë në datë 25.02.2019

Sekretare

Gjyqtare

Anjeza Nergjoni

Eneida Civici

Shpenzime gjyqësore

Taksë gjyqësore, mandat datë 13.07.2018 në vlerën 28,740.00 lekë

Shpenzime avokatore të palës së paditur,
sipas faturës nr.53, dt.09.10.2018 në shumën 48000 lekë

Fletëthirrje 600 lekë

Sekretare

Anjeza Nergjoni